



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Drejtoria e Antiterrorit

RELACION
PERFUNDIMTAR PËR PROCEDIMIN PENAL NR. 147, TË VITIT 2017

Z. Petrit HYSA
Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së
Shkallës së Parë Tiranë

Në Tiranë, viti 2020, muaji Qershor, datë 10.

Unë Ermal Deliu, Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Sektorit për Hetimin e Akteve Terroriste në Drejtorinë e Antiterrorit, i deleguar për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore lidhur me **Procedimin Penal Nr. 147, viti 2017**, për veprën penale të “Atentati” dhe “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuara nga nenet 219 e 79, të Kodit Penal në përfundim të tyre ju relatoj sa vijon:

Drejtoria e Antiterrorit me shkresë Nr. 315/1 Prot, date 14.04.2017, ka referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda materialin procedural që bën fjalë për veprën penale të: “Atentati” dhe “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuara nga nenet 219 e 79, të Kodit Penal.

Në intervistën e dhënë nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë **Bujar Nishani** në emisionin “**Arena**”, në stacionin televiziv **Ora News, të datës 13.04.2017**, i pyetur nga gazetari nëse ka dijeni për një kërcënim të mundshëm ndaj kryetarit të PD-së, Z. Lulëzim Basha, ka deklaruar se ka shumë aktor që duan de stabilitetin e Shqipërisë si dhe në lidhje me këtë çështje se “Siguria e aktorëve kryesor politik sidomos në situata shumë të tensionuara politike që mund të eskalojnë në tensione sociale, është një element shumë serioz. E dyta, asnjëherë nuk duhet të neglizhojmë faktin që nuk kemi vetëm miq, por ka dhe mjaft aktor të cilët punojnë dhe synojnë dhe investohen për të destabilizuar Shqipërinë, për të destabilizuar rajonin”.

Gjithashtu Presidenti tha se duhet të mos neglizhojmë dhe të mos mendojmë që nuk ekzistojnë tentativa të tilla. Fakti i sigurisë të liderit të opozitës, mund tju them vetëm këtë (sepse nuk mund të hyjë sot në detaje sepse është çështje shumë e ndjeshme), tashmë është duke u konsideruar dhe unë besoj do të konsiderohet me seriozitet nga agjencitë kryesore ligj zbatuese në vend.

Pas këtij informacioni nga ana e Drejtorisë së Antiterrorit është vlerësuar kjo deklaratë dhe është punuar në lidhje me këtë drejtim. Janë vërejtur se në dalje publike të liderit të opozitës kishte shtim të forcave të sigurisë.

Në kuadër të kësaj situatë të krijuar, me shkresë **Nr. 1669, të datës 14.04.2017**, ardhur nga shërbimet e Inteligjente jemi informuar mbi disa persona të dyshimtë dhe për të cilët janë grumbulluar informacione në lidhje me këtë çështje ku ka rezultuar si vijon.

Nga proceset e ndjekjes janë ngritur dyshime të arsyeshme se individët e njohur si **Afrim Morina**, i njohur si vrasës me pagesë, kanë dijeni apo lidhen me dyshimet për planifikimin

e një atentati në vendin tonë ndaj Kryetarit të Partisë Demokratike, Lulëzim Basha, me qëllim de stabilizimin e vendit.

Nga verifikimet e kryera janë siguruar disa të dhëna mbi identitetin e mundshëm të personave që mund ta kryejnë këtë atentat. Të dhënat e tyre janë si më poshtë:

1. **Afrim Morina**, i datëlindjes 20.12.1959, banues në Rr. "Pançe Poposki", Gostivar. Ky shtetas ka në përdorim numrin e telefonit +38970251943. Posedon automjetet tip Renault Laguna me targa GV-374-GV dhe automjet tip Daevo Nubira me targa GV-510-BF. Prej vitit 1998 është punonjës i policisë së Gostivarit në sektorin për krim dhe teknik/ Policisë Shkencore. Është person i përfshirë në veprimtari antiligjore trafik droge dhe njihet si një person, i cili është i gatshëm të bëjë gjithçka për para.
2. **Arben Ymeri**, i datëlindjes 27.08.1981 nga Prishtina, i njohur me nofkën "Japani". Praktikant radikal i fesë Islame, ish luftëtar xhihadist në Siri dhe lidhje me element radikal që kanë luftuar në Siri. Njihet si një person me rrezikshmëri të lartë. Është arrestuar në janar 2016, pasi është gjetur në rrugën e manastirit të Deçanit me uniformë dhe armë, së bashku me shtetasin Alban Kelmendi nga Ferizaj, Kujtim Kurti nga Gjakova dhe Kushtrim Rama, nga Rashkoci i Gjakovës.
3. **Fatmir Gurgurovci**, i datëlindjes 21.06.1966. I dyshuar si i përfshirë në atentatin e vitit 2010 ndaj Alfred Mustakës nga Durrësi, për shkak të konkurrencës lidhur me lojërat e fatit në Ferizaj, Kosovë.

Pasi janë kryer verifikimet e para hetimore, materiali është referuar për veprat penale të "Atentati" dhe "Vrasje në rrethana të cilësuar", që parashikohen nga nenet 219 dhe 79 të Kodit Penal.

Më datë 14 prill 2017, nga ana e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të Drejtorisë së Antiterrorit është kryer këqyrja e të dhënave në Internet, konkretisht të linkut "<http://www.balkanweb.com/site/>". Qëllimi i këqyrjes kanë qenë grumbullimi i të dhënave nga interneti dhe portalet ku gjenden deklaratat e Presidentit dhe shkrimet e botuara në shtypin e përditshëm. **Ndër shkrimet e botuara gjendet edhe shkrimi me titull, "Kërcënimi i Bashës", flet Nishani. Kishte një atentat të organizuar" që mban orën 22:25, të datës 13.04.2017. Këtu gjendet e gjitha deklarata e presidentit e dhënë në emisionin "Arena", në ora Neës.**

Në datën 14.04.2017, nga ana e oficerëve të Policisë gjyqësore në Drejtorin e Antiterrorit është kryer këqyrja e Sistemit TIMS.

Objekti i këqyrjes ka qenë verifikimi nëpërmjet sistemit TIMS, nëse shtetasit **Afrim Morina**, i datëlindjes 20.12.1959, banues në Gostivarë Maqedonia e Veriut, ka hyrë apo ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë. Konstatohet se ky shtetas ka disa hyrje dalje nga Shqipëria. Hyrja e fundit në republikën e Shqipërisë është në datën 09.08.2014, nëpërmjet pikës kufitare Qafë Thanë me automjetin me targë GV374CE. Ky shtetas ka dalë nga republika e Shqipërisë më datë 16.08.2014 po nga pika kufitare Qafë Thanë, me automjetin CV374CE.

Po kështu vazhdohet edhe për shtetasin **Arben Ymeri**, i datëlindjes 27.08.1981, kontrollohen rubrikat e hyrje – dalje. Konstatohet se ky shtetas ka disa hyrje – dalje nga Republika e Shqipërisë. Tek rubrika hyrje rezulton që ka hyrë për herë të fundit në datën 13.06.2016 nga Pika e Kalimit të Kufirit Morinë me automjetin me targa 01-224-IE.

Po kështu vazhdohet edhe për shtetasin Fatmir Gurgurovci, i datëlindjes 21.06.1966, kontrollohen rubrikat e hyrje – dalje. Konstatohet se ky shtetas ka disa hyrje – dalje nga

Republika e Shqipërisë. Tek rubrika hyrje rezulton që ka hyrë për herë të fundit në datën 03.02.2010, nga Pika e Kalimit të Kufirit Qafë Thanë.

Sipas këtij proces verbali të këqyrjes së sistemit TIMS për të tre shtetasit e përmendur rezulton se këta shtetas kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë përpara datës për të cilën kryen hetimet. Këqyrjet janë shoqëruar edhe me printime nga sistemi TIMS për të tre këta shtetas.

Në kuadër të Procedimit Penal Nr. 147, viti 2017, Prokuroria ka përpiluar kërkesën për vlerësimin e vendimit ambiantal drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Në kërkesën për vlerësimin e Vendimit të lejimit të përgjimit ambiantal, ndër të tjera kërkohet:

Duke u bazuar në kërkesat e nenit 222/2 të K. Pr. Penal i paraqitet kërkesa në funksion të Procedimit Penal Nr. 147/2017, për veprat Penale të “Atentat” dhe “ Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuara nga nenet 219 e 79, të Kodit Penal.

Nga të dhënat e administruara nga policia gjyqësore rezulton, se nga organet ligj zbatuese në vend janë siguruar informacione se disa shtetas të përmendur më lartë, kanë dijeni apo lidhen me dyshime për planifikimin e një atentati në vendin tonë ndaj Kryetarit të Partisë Demokratike Z. Lulzim Basha, me qëllim de stabilizimin e vendit. Në bazë të informacioneve të mara rezulton se këta persona paraqesin rrezikshmëri të lart shoqërore.

Përdoruesi i numrit të telefonit +38970251943 shtetasi **Afrim Morina**, dyshohet se kryen biseda të dyshimta lidhur me veprat penale për të cilat po hetohet. Përgjimi duhet të lejohet nga ligji pasi plotësohen kriteret ligjore që parashikon neni 221.1, germa “ a”, i K.Pr. Penal mbi kufijtë e lejuar për përgjim, dhe i gjithë parashikimi ligjor për veprat e përmendura më lartë si dhe kufijtë e dënimit për këto vepra penale. Për këto arsye duke marr parasysh se vonesa mund të shkaktohet dëm në hetimin e këtij procedimi, është e nevojshme të vendoset lejimi i përgjimit të komunikimit telefonik i numrit të celularit, për një periudhë prej 15-ditësh. Për këto arsye është kërkuar nga Prokurori vlerësimi i vendimit të lejimit të përgjimit me vendim të Gjykatës.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, ka nxjerr Vendimin për vlerësimin e përgjimit telefonik, me Nr. 489, datë 17.04.2017, ku ka vendosur Pranimin e Kërkesës, vlerësimin e ligjshëm të Vendimit të Prokurorisë.

Në datën 16.04.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda është përpiluar urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore në lidhje me Procedimin Penal Nr. 147, viti 2017, për veprat penale të parashikuara nga nenet 219 dhe 79, i Kodit Penal. Detyrat e deleguara janë:

1-Të bëhet këqyrja e sistemit TIMS për të dokumentuar hyrje daljet e shtetasve të dyshuar në Republikën e Shqipërisë.

2-Të komunikohet me zyrën e përgjimit në Prokurorinë e përgjithshme për ecurinë e përgjimeve telefonike.

3-Të komunikohet në vijim dhe të kërkohen të dhëna nga Drejtoria e Antiterrorit nëse ka informacione të tjera lidhur me hetimin që po kryhet. Të dhëna që kanë lidhje me numrin e telefonit apo personat e dyshuar.

4-Të kryhen të gjitha veprimet që do të dalin nga dinamika duke njoftuar në çdo rast prokurorin e çështjes.

Veprimet hetimore të kryhen brenda datës 30.06.2017.

Pas kryerjes së veprimeve të përpilohet një relacion përkatës.

Në vijim të këtyre detyrave janë kryer të gjitha veprimet për të bërë të mundur zbulimin e autorëve.

Janë kryer veprimet në sistemin TIMS për shtetasit:

- 1-**Fatmir Gurgurovci**, i datëlindjes 20.06.1966, banues në Kosovë.
- 2-**Arben Ymeri**, i biri i Syl, i datëlindjes 27.08.1981, banues në Kosovë.
- 3-**Afrim Morina**, i datëlindjes 20.12.1959, banues në Maqedoni, me detyre punonjës i Policisë.

Gjithashtu nga Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjimeve elektronike, është dërguar materialet e përgjimeve të telekomunikimeve.

Drejtoria e Antiterrorit, nisur nga kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda, e cila me Nr. 6199 Prot./A.L, datë 20.06.2017, ka kërkuar nëse ka informacione në lidhje me hetimin Nr. 147, viti 2017. Drejtoria e Antiterrorit me Nr.315/1Prot, datë 30.06.2017, i ka kthyer përgjigje Prokurorisë.

Drejtoria e Antiterrorit me shkresë Nr. 315/1 Prot, datë 14.04.2017, ka dërguar materialet procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda, për veprën Penale të “Atentatit” dhe “Vrasje në rrethana të tjera të cilësuar”, vepra këto që parashikohen nga nenet 219 dhe 79 të Kodit Penal.

Në materialin e Referimit ndër të tjera theksohet:

Intervista e dhënë nga presidenti i Republikës Z. Bujar Nishani në emisionin “Arena”, në TV Ora News, të datës 13.04.2017. Presidenti tha se asnjëherë nuk duhet të neglizhohet dhe të mos mendojmë që nuk ekzistojnë tentativa dhe kërcënime për eliminimin fizik ndaj kryetarit të PD-së, Z. Lulzim Basha. Gjithashtu për këtë çështje ka pasur edhe informacione nga shërbimet e Inteligjencës në vend, ku ka pasur informacion mbi disa persona të dyshimtë dhe janë grumbulluar informacione në lidhje me këtë çështje.

Në informacion përmenden shtetasit.

- 1-**Fatmir Gurgurovci**, i datëlindjes 20.06.1966, banues në Kosovë.
- 2-**Arben Ymeri**, i biri i Syl, i datëlindjes 27.08.1981, banues në Kosovë.
- 3-**Afrim Morina**, i datëlindjes 20.12.1959, banues në Maqedonin, me detyre punonjës i Policisë.

Në veprimet e kryera është Këqyrja e të dhënave në Internet për këta çështje, si intervista e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, ky flitet për kërcënimin e kryetarit të PD-së Z. Lulzim Basha. Është kryer këqyrja e sistemit TIMS për të tre këta shtetas. Nga këqyrja rezulton se këta shtetas kanë hyrje – dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë por nuk ka hyrje në kohën që kanë filluar hetimet. Këqyrja është kryer në datën 14.04.2017.

Gjithashtu me shkresë Nr. Extra Prot, datë 16.04.2017, për këtë hetim është kryer edhe përgjimi ambiantal, duke i dërguar kërkesën Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, kërkesa është bërë nga Prokuroria pranë shkallës së Parë për krimet e Rënda. Në këtë shkresë është kërkuar Vlerësimi i Vendimit për Lejimin e përgjimit të telekomunikimeve të numrit të telefonit celular **+38970251943 në përdorim të shtetasit Afrim Morina**, për një periudhë 15 ditore duke filluar nga ora 15.00 e datës 15.04.2017.

Në datën 15.04.2017, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së parë për krimet e Rënda Tiranë ka përpiluar Vendimin për Autorizimin e Përgjimit telefonik celular +38970251943 në përdorim të shtetasit Afrim Morina.

Në datën 16.04.2017, është kryer Kërkesa për Vlerësimin e Vendimit të Lejimit të Përgjimit. Kërkesa është bërë për shtetasin Kosovar Afrim Morina.

Në datën 28.04.2017, nga ana e Prokurorisë është përpiluar kërkesa për zgjatjen e afatit të përgjimit telefonik. Përdoruesi i numrit +38970251943, shtetasi Afrim Morina i cili dyshohet për kryerjen e veprave penale 219 dhe 79 të Kodit Penal.

Në datën 29.04.2017, Gjykata e Shkallës së parë për Krimet e Rënda ka marr Vendimin për zgjatjen e Afatit të përgjimeve telefonike për shtetasin Afrim Morina, përdorues i numrit të telefonit +38970251943.

Në datën 28.04.2017, Oficeri i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e krimeve të Rënda, në bazë të nenit 293 të Kodit të Procedurës Penale ka përpiluar Informacionin mbi Procedimin Penal 147, viti 2017. Ku rezulton se nga ana e organeve ligj zbatuese janë siguruar Informacione se disa shtetas dhe konkretisht shtetasit Afrim Morina, lindur e banues në Gostivar Maqedonia e veriut, me detyrë punonjës i Policisë Kriminale në Maqedoni, Arben Ymeri, lindur e banues në Prishtinë Kosovë, dhe Fatmir Gurgurovci, lindur e banues në Ferizaj Kosovë, kanë dijeni apo lidhen me dyshime për planifikimin e një atentati në Republikën e Shqipërisë ndaj Kryetarit të PD-së Z. Lulzim Basha, me qëllim të stabilizimit e vendit tonë. Personat paraqesin rrezikshmëri të madhe shoqërore.

Përdoruesi i numrit +38970251943 shtetasi Afrim Morina dyshohet se kryen biseda të dyshimta lidhur me veprat penale 219 dhe 79 të Kodit Penal.

Në datën 16.04.2017, Prokurori i çështjes ja delegon këtë dosje për veprime të mëtejshme Oficerit të Policisë Gjyqësore për kryerjen e disa detyrave.

1-Të bëhet këqyrja e sistemit TIMS për të dokumentuar hyrje daljet e shtetasve të dyshuar në Republikën e Shqipërisë.

2-Të komunikohet me zyrën e përgjimit në Prokurorinë e përgjithshme për ecurinë e përgjimeve telefonike.

3-Të komunikohet në vijim dhe të kërkohen të dhëna nga Drejtoria e Antiterrorit nëse ka informacione të tjera lidhur me hetimin që po kryhet. Të dhëna që kanë lidhje me numrin e telefonit apo personat e dyshuar.

4-Të kryhen të gjitha veprimet që do të dalin nga dinamika duke njoftuar në çdo rast prokurorin e çështjes.

Veprimet hetimore të kryen deri në datën 30.06.2017.

Me shkresë Nr. 612/3Prot, datë 29.10.2018, Drejtoria e Antiterrorit i ka dërguar Informacion Prokurorit Për krimet e Rënda, në lidhje Procedimin penal Nr.147, viti 2017.

Në këtë informacion ndër të tjerat theksohet se:

Nga verifikimet e kryera në vazhdimësi, nuk disponohen të dhëna të reja lidhur me personat të implikuar apo shtetas të tjerë Shqiptarë dhe të huaj të cilët mund të ishin të përfshirë në atentatin e mundshëm ndaj liderit të opozitës.

Nga verifikimi dhe komunikimi me Zyrën Qendrore Kombëtare, Interpol Tirana për rekorde kriminale në vendet e tyre për këta shtetas ka rezultuar se:

Për shtetasin Arben (Sylë)Ymeri, i datëlindjes 27.08.1981, fshati Zllatarë, Prishtinë, pasaporta P00184947, ID 1003850532, me profesion është taksist, posedues telefonin 049707013, 044662706, janë zhvilluar hetime nga Drejtoria Kundër Terrorizmit Kosovë, rezulton se ky shtetas është i arrestuar dhe është dënuar për veprën penale armëmbajtje pa leje, dënim i cili ende nuk është ekzekutuar dhe për momentin është në liri. E kaluara e tij kriminale përveç rastit të mësipërm ai ka dhe 16 incidente si: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, kanosje, prodhim dhe shpërndarje e produkteve të dëmshme mjekësore.

Për shtetasin Fatmir (Ibish) Gurgurovci, i datëlindjes 21.06.1966, në Kosovë, Rr. "V. Gërvalla" Nr. 81, Ferizaj, menaxher në Zvicër, numri Personal 2006727657, telefon 0447806633, 044620118, ai nuk është subjekt i Drejtorisë Kundër Terrorizmit në Kosovë. E kaluara e tij kriminale rezulton me 11 raste si i dyshuar për: Kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, kërcënim, vrasje, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, lëndim i lehtë trupor.

Gjithashtu ju sqarojmë se për shtetasin **Afrim Morina**, i datëlindjes 20.12.1959, banues në Krugën "Pance Poposki", Gostivar Maqedonia, Interpol Shkup Maqedoni nuk ka dërguar

të dhëna për këtë shtetas, pasi kërkojnë të dhëna shtesë dhe një përshkrim të shkurtër të rastit ku implikohet shtetasi i mësipërm.

Drejtoria e Antiterrorit me Nr. 612/1, Prot, datë 08.10.2018, i ka dërguar materiale procedurale shtesë, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë për krimet e Rënda.

Materialet është :

Procesverbal këqyrje të sistemit TIMS, bashkë me të dhënat e printuara për shtetasit Afrim Morina, Arben Ymeri dhe Fatmir Gurgurovci.

Këqyrja është kryer më datë 02.10.2018.

Për shtetasin Afrim Morina, rezulton se ky shtetas ka disa hyrje dalje nga Republika e Shqipërisë. **Hyrja e fundit është në datën 28.08.2018, ora 08.07, nëpërmjet Pikës së kalimit Kufitar Qafë Thanë me automjetin me targa GV3001AC.** Tek rubrika Dalje rezulton se ky shtetas ka dalë për herë të fundit nga Republika e Shqipërisë më datë 31.08.2018 ora 17.30, nga pika e kalimit të Kufirit Qafë Thanë, me automjetin GV3001AC. Më pas kalohet tek Rubrika “Njoftim në Kufi”, ku shfaqet njoftimi për informim e kërkuar nga Drejtoria e Antiterrorit me shkresë. Extra(315/2), datë 14.05.2017. Në vazhdimësi klikohet në rubrikën “i verifikuar”, ku shfaqen dy verifikime, verifikimi i parë është në datën 09.07.2017 ora 11.54 në Pikën e Kalimit të Kufirit të Qafë Thanë. Verifikimi dytë është në datën 28.08.2018, ora 09.48, në Pikën e Kalimit të Kufirit të Qafë Thanës.

Më pas kryen verifikime në TIMS për shtetasin Arben Ymeri, i datëlindjes 27.08.1981. Shkohet tek rubrika Hyrje- Dalje., ku rezulton se ky shtetas nuk ka të regjistruar hyrje në Republikën e Shqipërisë. Në rubrikën Dalje nga Republika e Shqipërisë rezulton se ky shtetas të ketë dalë disa herë nga Republika e Shqipërisë, ku dalja e fundit rezulton të jetë në datën 13.06.2016, ora 21.17, nga Pika e Kalimit të Kufirit Morinë, me automjetin me targa 01-224-IE. Më pas shkojmë tek rubrika e “Njoftimit në Kufi”, ku shfaqet njoftimi për informim e kërkuar nga Departamenti për Hetimin e Krimeve me shkresën Extra(315/2), datë 14.04.2017. Më pas klikojmë në njoftimin e dytë po të kësaj rubrike ku thuhet se është në kategorinë e “Për Informim”, me shkresën Extra, datë 12.11.2016.

Për shtetasin Fatmir Gurgurovci, i datëlindjes 21.06.1966. Shkojmë tek rubrika “Hyrje – Dalje”, ku rezulton se ky shtetas të ketë hyrë në Republikën e Shqipërisë disa herë ku hyrja e Fundit në Republikën e Shqipërisë është në datën 02.02.2010, ora 20.18, nëpërmjet Pikës së Kalimit të Kufirit Muriqan. Tek rubrika “Dalje” nga Republika e Shqipërisë rezulton që ky shtetas të ketë dalë disa herë, **ku dalja e fundit rezulton të jetë në datën 03.02.2010, ora 11.18, nga Pika e Kalimit Kufitar Qafë Thanë.** Në vazhdim tek rubrika “Njoftime në Kufi”, shfaqet njoftimi “Për Informacion”, e kërkuar nga Departamenti për Hetimin e Krimeve me shkresë Extra (315/2), datë 14.04.2017. Gjithashtu këqyrja është shoqëruar me fletët e printuara nga sistemi TIMS, për të tre këta shtetas.

Drejtoria e Antiterrorit me shkresë Nr. 119 Prot, datë 15.02.2019, i ka dërguar Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda Tiranë materialet procedurale si më poshtë.

Procesverbalin e këqyrjes së sistemit TIMS,

Proces verbalin e Këqyrjes së telefonit me numër 0038349283539, të kompanisë IPKO, me numër karte Sim 109030-937171 dhe Nr. IMEI 355982083115949, në përdorim të shtetasit Arben Ymeri, datë 14.02.2019.

Nga kjo këqyrje konstatohen se telefoni është i markës Samsung-S8, model numër SM-G 950U, Software Version MSM 8998.00, me ngjyrë të ngjashme me atë të floririt, me ekran me ngjyrë të zezë , me tach, në pronësi të shtetasit Arben Ymeri, i biri i Syl, i datëlindjes 27.08.1981. Telefoni ka qenë i ndezur dhe në gjendje pune. Passëordi i telefonit është “ japa1”. Më pas vazhdohet me këqyrjen e telefonit . Është shkruar tek rubrika “Contact”, në

telefon gjenden të regjistruar 29(njëzetënëntë) numra telefoni, të rreshtuar në këtë telefon. Shumica e numrave të telefonit janë të Kosovës por ka edhe të shteteve të tjera.

Ka edhe numra të kompanive telefonike të Shqipërisë. Këta numra janë.

- 1- Ekzontusha(Ekzon Tusha), +355688231862. Numri 12 në këqyrje.
- 2- Hima Travel, +355694767427. Numri 14 në këqyrje.
- 3- Lulzim Kastrati, +355692058120. Numri 17 në këqyrje.
- 4- Taxi, +355674006610. Numri 25 në këqyrje.
- 5- (Nuk ka emër), +355684611919. Numri 27 në këqyrje.

Në këtë listë vërehet se ka përrputhje midis deklarimit që ka dhënë shtetasi Arben Ymeri, në lidhje me personat që njehë dhe ka takuar në Shqipëri, motivi dhe qëllimi i lëvizjes, për të realizuar emigrimin e tij dhe të familjes për në Angli. Në këtë proces verbal të këqyrjes së telefonit janë shpjeguar edhe komunikimet duke këqyruar edhe rubrikën “recent”, ku ndodhen të gjitha komunikimet që ka kryer Arben Ymeri.

Në datën 15.02.2019, ka komunikuar me një numër telefoni në Monako me numrin +37744474177. Ka komunikuar edhe me shtetasin Jeton Dile. Ka komunikime me shtetasin Arben Dragusha, i cili është buri i motrës. Shumica e telefonatave që ka kryer Arben Ymeri janë të rrethit të tij familjar dhe shoqëror dhe disa nga këto telefonata kanë të bëjnë me përpjekjet dhe interesimin që ka ky shtetas për të emigruar në Angli, së bashku me familjen e tij.

Në këqyrje është përkthyer edhe rubrika e Messenger, Viber dhe WhatsApp. Edhe në këto rubrika Arben Ymeri komunikon me Lulzim Kastratin për të emigruar në Angli, së bashku me familjen e tij. Këto telefonata janë të shtrira në kohë të largët me atë që ka ë bëmë me qëllimin e hetimit.

Procesverbalin e sekuestrimit të sendeve telefon me numër 0038349283539, me numër karte Sim 109030-937171, dhe Nr. IMEI 355982083115949, në përdorim të shtetasit Arben Ymeri, datë 14.02.2019.

Në datën 14.02.2019, në qytetin e Kukësit nga Oficerët e Drejtorisë së Antiterrorit është mbajtur procesverbal për marrjen e të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale, shtetasit Arben Ymeri, datë 14.02.2019.

Arben Ymeri, i biri i Syl-ës dhe i Bahtie-s, i datëlindjes 27.08.1981, lindur në Prishtinë dhe banues në Prishtinë, lagja Zllatar(Lukmir), banës private pa numër, disponon numër telefoni 0038649550039.

Në deklarimin e tij ky shtetas shpjegon se :

Arben Ymeri është i martuar me shtetasen **Arjeta Krasniqi**, (ka mbajtur mbiemrin e sajë). Kanë katër fëmijë, të gjithë djem, të cilët janë Leutrim Ymeri 12 vjeç, Omer Ymeri 9-vjeç, Hudheife Ymeri 6-vjeç, dhe Ajan Ymeri 2-vjeç. Arbeni jeton së bashku me prindërit e tij, ata janë katër fëmijë dy vëllezër dhe dy motra. Fëmija i parë është motra Valbona Ymeri, e martuar me shtetasin Fazli Mjeku, banues në Malishev Prishtinë, i dyti vëllai Ismet Ymeri, i martuar me shtetasen Qefsere Ymeri(Islami), me banim në Gjermani, qyteti Hamburg., i treti Amir Ymeri, i cili ndodhet në Angli, dhe fëmija i katërt është Arben Ymeri, fëmija i fundit është motra Suzana Dragusha e martuar me shtetasin Arben Dragusha me banim në Prishtinë Kosovë.

Në vitin 1997 Arbeni ka qenë në shkollën e mesme “Gjin Guzulli”, dega elektroenergjitë, të cilën e ka lenë pa mbaruar për shkak të luftës në Kosovë. Mbas shkëputjes nga shkolla Arbeni i është bashkuar UÇK-së në zonën e Rahovecit e Malishevës. Në luftë ka marr pjesë si ushtar i thjeshtë, dhe për shkak të moshës nuk është angazhuar shumë në luftime. Një muaj përpara se të mbaronte lufta është shkëputur prej saj pasi është njoftuar se vëllai i quajtur Amir e kishin arrestuar Serbët dhe e kishin çuar në Bllacë, e cila ndodhet në një zonë midis kufirit të Kosovës dhe Maqedonisë. Më pas ka mësuar se vëllain e ka ndihmuar një organizatë Humanitare, Angleze të cilët e kanë dërguar në Angli ku ndodhet edhe

aktualisht në qytetin Doncaster, i pajisur me pasaportë Angleze, më pas është martuar dhe ka tre fëmijë. Pas luftës Arbeni është kthyer në Prishtinë dhe ka vazhduar jetën normale, ka vazhduar shkollën dhe ka punuar si marangoz. Pas vitit 2007 ka punuar si shofer taksie në disa kompani dhe konkretisht “Velania”, “Blu Taksi”, “Titanik”, “Golden”, London-Taxi”Robert-Taxi, dhe në fund kompania Beki. Në momentin e deklaramit Arbeni ishte i pa punë prej tre muajsh.

Arbeni ka qenë i dënua, i akuzuar nga Policia e Kosovës për “Vepra Terroriste”. Është arrestuar së bashku me shtetasin Kushtrim Rama, e Kushtrim Kurti, nga Gjakova si dhe Alban Kelmendi nga Ferizaj. Policia e Kosovës pasi i ka ndaluar ka ushtruar kontroll në automjetin tip “Golf”, pronë e Albanit. Gjatë kontrollit Arbenit i është gjetur një pistoletë, në bagazh e makinës është gjetur një automatik që ka qenë i shtetasit Kushtrim Rama. Ka qëndruar një muaj në arrest dhe më pas ka dalë nga burgu me akuzën e armëmbajtjes pa leje.

Në mars të vitit 2014, Arbeni ka kaluar nga Serbia, në Hungari, më pas në Austri. Aty është kapur dhe është dërguar në një kamp refugjatesh në afërsi të Salsburgut, ku ka qëndruar 7 muaj. Në këtë kamp refugjatësh është njohur më shtetasin Kushtrim Rama dhe Alban Kelmendin, ndërsa me shtetasin Kushtrim Kurti është njohur në Kosovë, i cili është lidhje shoqërore e shtetasit Kushtrim Rama, dhe njëkohësisht është edhe dhëndri i Alban Kurtit. Shoqërinë e ruajnë akoma por jo takime të shpeshta nga frika se mund të paragjykoen. Arbeni nuk ka qenë në asnjë vend tjetër përveç atyre të përmendura. Ka qenë në Turqi, në vitin 2008 ose 2009, me pushime së bashku me bashkëshorten e tij dhe djalin për të bërë edhe disa vizita shëndetësore. Aktualisht është me një veshkë sepse rreth vitit 2005, i ka dhuruar një veshkë shokut të tij të luftës Mehdi Gashi nga Prishtina.

Arbeni ka ardhur në shumë raste në Shqipëri për qëllime si vizitor për pushime. Ka ardhur i shoqëruar nga shoqëria e tij si dhe me familjen.

Në shkurt të vitin 2019, Arbeni ka ardhur në Shqipëri i cili ka qenë i shoqëruar nga shoku i tij shtetasi Jeton Brahim Dile, i cili është dhëndri i xhaxhait. Dhe shtetasi Enes Ekrem Ymeri, ky është djali i xhaxhait. Qëllimi i ardhjes ka qenë edhe për të gjetur një mundësi për të emigruar në Angli. Përpara se të vinte në Shqipëri Arbeni ka kontaktuar me një shokun e tij i cili quhet Agron Mulodhi cili i kishte rekomanduar për të takuar në Kukës shtetasin Ekzon Tusha, i cili do ti jepte mundësinë për ta ndihmuar për të ikur në Angli. Arbeni është takuar me Ekzonin në Kukës, i cili ka qenë i shoqëruar nga babai i tij. Babai i Ekzonit i ka thënë që ka një mikun e tij në Durrës i cili quhet **Lulzim Kastrati**, të cilin e kanë orientuar që ta takonte dhe të mbante lidhje i cili do ti krijonte mundësinë për të emigruar për në Angli. Arbeni ka ardhur në Durrës aty është takuar me shtetasin **Lulzim Kastratin**, ata janë takuar tek lokal Miramare. Arbeni i është prezantuar Lulzimit si miku i shtetasit **Ekzon Tusha**, dhe i ka kërkuar që ta ndihmoj për të shkuar në Angli si emigrant sëbashku me familjen.

Në datën 14.02.2019, Arbeni ka hyrë në Morinë dhe ka shkuar për në Durrës. Ka komunikuar në “Viber” me Lulzimin, takimi është bërë përsëri tek lokal “Miramare”.

Arben Ymeri njih mirë dhe komunikon në gjuhën Serbe dhe Angleze. Është besimtar i fesë myslimane, frekuenton xhamin e lagjes së tij ku imam është shtetasi **Dritan Haziri**. I pëlqen dhe ka kryer ritet fetare edhe Imami i xhami së madhe Shefqet Krasniqi. Nuk ka pasur gjë tjetër me interes në deklaramin e shtetasit Arben Ymeri.

Gjithashtu në datën 15.02.2019, nga ana e Oficerëve të Drejtorit të Antiterroit është kryer edhe Proces – Verbali i këqyrjes së Sistemit TIMS, për lëvizjet e shtetasit Arben Ymeri i biri i Syl, i datëlindjes 27.08.1981.

Në këtë këqyrje evidentohen hyrje- daljet e këtij shtetasi.

Tek rubrika “Hyrje”, ky shtetas nuk rezulton që të jetë regjistruar në hyrje në Republikën e Shqipërisë.

Tek rubrika “Dalje”, rezulton të ketë 7 (shtatë) dalje. E para në datën 10.11.2015, nga P.K.Kufitar Morinë, me auto veturë 01-148-HL. Dalja e fundit është më datë 15.02.2019, nga P.K.Kufirit Morinë, me ato veture me targa AA145OP.

Tek rubrika “Njoftim në Kufi”, rezulton se më datë 14.04.2017, Drejtoria e Antiterrorit me shkresë Extra.(315/2), datë 14.04.2017, kërkohet vendosja në rubrikën njoftim në kufi për shtetain Arben Ymeri, me Nr.Personal 1003850532.

Drejtorisë e Antiterrorit, me Nr.119/5 Prot, datë 08.10.2019, i ka dërguar Prokurorisë së Shkallës së Parë për krimet e Rënda materiale procedurale shtesë në lidhje me Procedimin Penal Nr.147, viti 2017. Në këto materiale shtesë janë këto dokumente:

Vendimin për kryerjen e ekspertimit kompjuterik.

Në këtë vendim është kërkuar:

-Ekspertimi i telefonit celular “SAMSUNG”S-8, Model SM-G950U, Softëer Version MSM 8998.00, me numër IMEI 355982083115949, i cili hapet me kodin ose Passëodin “japa1”.

-Karta e telefonit që i përket kompanisë “IPKO”, me numër telefoni 0038349283539, me numër karte Sim 109030-937171, me kodin pin “japa1”.

Në këtë vendim është kërkuar nxjerra e të gjitha të dhënave të mundshme, thirrjeve prej ose drejt tyre, sms-ve, Fotove, Videove, numrave të memorizuar si dhe çdo e dhënë tjetër që mund të nxirret apo që mund të jetë fshirë, nga memoria e telefonit. Të dhënat të vihen në dispozicion në formë elektronike në një CD. Vendimi i është dërguar Institutit të Policisë Shkencore.

Instituti i Policisë Shkencore ka përpiluar Aktin Nr. 9846, datë 02.10.2019. Në këtë Akt Ekspertimi ndër të tjerat na është dërguar :

-Cilësitë e Objektivit të Ekspertimit. Përcaktohen të thitha karakteristikat e celularit Samsung S-8, si dhe karta e telefonit që ndodhet në këtë celular.

-Këqyrja dhe Ekzaminimi Kriminalistik.

Objekti i Ekspertimit është Aparati telefonik Samsung S-8, me të gjitha karakteristikat e tij.

-Më pas telefoni është konëktuar në gjendje të fikur pa kartën Sim, me pajisjen ekzaminuese “UFED Touch v.7.23” me anë të cilës u ekstraktuan të dhënat me metodat e ekstraktimit logjik dhe file sistem.

Më pas ekstraktet u ngarkuan në programin “UFED Physical Analyzer v.7.23.01” me anë të cilit u dekoduan dhe eksportuan të dhënat. Nga analizimi i të dhënave janë marr shumë të dhëna për cilësitë dhe karakteristikat e celularit, të gjitha veprimet që ka kryer ky celular, koordinatat gjeografike(GPS), vendndodhjet, mesazhet, sms, skedën audio, skedën grafike, skedarë video, etj.

Të gjitha të dhënat e përfuara janë ruajtur në dosjen me emërtimin “Samsung SM-G950U.PDF”, si dhe dosjen me emërtimin “Samsung SM-G950U.UFDR”.

-Për modelin e telefonit celular objekt ekspertimi nuk suportohet nxjerrja e të dhënave në lidhje me aplikacionet e instaluara dhe përdorura në të, si dhe historia e navigimeve në Internet.

Në telefonin celular janë të instaluara aplikacione të shumta.

- Aplikacioni “Gmail”, është konfiguruar dhe profili “Andrej Koren”, me adresë e-maili”andrejkoren71@gmail.com, kjo adresë mund të përdoret në internet, duke pasur edhe passwordin. **Por lidhja me internetin mbart rrezikun potencial të fshirjes permanente (në mënyra të pakthyeshme), të dhënave në telefon, nëse përdoruesi ka aktivizuar komandën e fshirjes në distancë së të dhënave.**
- Në aplikacionin “facebook”, është përdorur llogaria ”Andrej Koren’. Me anë të këtij aplikacioni mund të shikohen kontaktet e profilit në rrjetin social “facebook”, postimet e ndryshme të bëra. Komunikimet nuk aksesohen, por ato aksesohen me aplikimin “facebook Messenger”. Këto të dhëna mund të kryhen duke ndezur aparatit e telefonit celular dhe duke e lidhur me internetin, duke aksesuar llogarinë në fjalë, **Por lidhja me internetin**

mbart rrezikun potencial të fshirjes permanente (në mënyra të pakthyeshme), të dhënave në telefon, nëse përdoruesi ka aktivizuar komandën e fshirjes në distancë së të dhënave.

- Në aplikacionin “Instagram”, është konfiguruar dhe përdorur profili “andrej.koren.376”, të gjitha të dhënat në këtë aplikacion janë fotografuar dhe janë futur në akt ekspertim. Komunikimet (chating), janë vetëm ato që kanë mbetur në memorien e telefonit celular. Komunikime të tjera mund të merren duke ndezur telefonin dhe duke e lidhur me internetin, pasi të keni riparuar ekranin e telefonit celular, **por lidhja me internetin mbart rrezikun potencial të fshirjes permanente (në mënyra të pakthyeshme), të dhënave në telefon, nëse përdoruesi ka aktivizuar komandën e fshirjes në distancë së të dhënave.**
- Po kështu mund të vazhdohet edhe me aplikacionet “mesessenger”, aplikacioni “Email”, nuk është i konfiguruar për përdorim. Aplikacioni “Viber”, është i konfiguruar me profilin “Andrej”, me numër telefoni “+38949283539”. Të gjitha kontaktet janë fotografuar dhe u ruajtën në dosjen e emërtuar “Të dhënat e Aplikacionit Viber”.
- Në aplikacionin “WhatsApp”, përsëri është konfiguruar përdoruesi “Andrej”, me numër telefoni “+38949283539”. Edhe këto të gjitha komunikimet janë fotografuar dhe janë ruajtur në dosjen “Të dhënat e aplikacionit WatsApp”.
- Po kështu janë ruajtur dhe të dhënat për aplikacionet “Photos”, i përdorur në konfigurimin “Andrej Koren”, me adresë emaili, andrej.koren71@gmail.com. Këto të dhëna mund të ngarkohen ose mund të merren nëse ndizet telefoni dhe lidhesh me internetin. **Por lidhja me internetin mbart rrezikun potencial të fshirjes permanente (në mënyra të pakthyeshme), të dhënave në telefon, nëse përdoruesi ka aktivizuar komandën e fshirjes në distancë së të dhënave.**

Me anë të ekzaminimit manual fotografohen vetëm të dhënat që janë të ruajtura në memorien e telefonit celular dhe nuk mund të rikuperohen të dhëna të fshira. Telefoni ka dhe një kartë “SIM”, të kompanisë telefonike celulare “Mobil Tel”, që operon në Slloveni. Karta është e mbyllur me një Kod “PIN”, dhe për këtë arsye nuk mund të ekzaminohet.

Në përfundim të ekzaminimit arrihet në konkluzionet :

Nga memoria e telefonit objekt ekspertimi i markës Samsung Model : SM-G950U, u nxorën të gjitha të dhënat e ruajtura në memorien e tij. Për këtë model telefoni programet ekzaminuese aktualisht suportojnë vetëm nxjerrjen e të dhënave si kontakte telefonike, thirrje telefonike, mesazhet SMS, por nuk mund të rikuperohen të dhënat e fshira. Konkretisht për modelin e telefonit objekt ekspertimi nuk suportohet nxjerrja e të dhënave në lidhje me aplikacionet e instaluara dhe përdorura në të, si dhe historia e navigimit në internet.

Të gjitha të dhënat janë venë në dispozicion në formatin “pdf”, i cili hapet me programin “Acrobat Reader”, si dhe në formatin “ufdr”.

Për leximin e të dhënave në formatin “.ufdr”, në folderin përkatës ku gjenden të dhënat e nxjerra nga ky telefon duhet të hapet programi që gjendet brenda këtij folderi, përkatësisht “CellebriteReader.exe”. Ky program nuk ka nevojë për instalim, mjafton të klikohet mbi të dhe ai hapet. Ky program funksionon në kompjuterët me sistem Windows 7 e lart. Bashkëlidhur këtij Akti Ekspertimi ju dërgojmë dhe një manual për përdorimin e programit “CellebriteReader.exe”.

Bashkë me Aktin e Ekspertimit është edhe prova materiale objekt ekspertimi.

Aktin i bashkëlidhet një DVD me të dhënat sipas përshkrimeve në aktin e ekspertimit, si dhe tabela fotografike e provës objekt ekspertimi.

Gjithashtu i gjithë Akt Ekspertimi i kryer nga Instituti i Policisë Shkencore, nga specialistët e Ekzaminimit Kompjuterikë, është i pasqyruar edhe me printime të çdo të dhëne që është gjendur në telefonin Samsung objekt ekspertimi.

Në të gjitha këto të dhëna nuk është konstatuar ndonjë e dhënë konkrete që të ketë të bëj me hetimin dhe me dyshimet e ngritura për këtë shtetas. Në të gjitha komunikimet e tij vërehet se ai komunikon për probleme personale si dhe me disa shtetas të cilët i kanë premtuar emigrimin e tij në Angli. Këto komunikime janë përshkruar në këtë relacion. Shtetasi **Arben Ymeri**, ka tentuar që së bashku me familjen e tij të largohet nga Kosova dhe të emigroj për në Angli, për arsye ekonomike. Për këto motive ai ka kontaktuar disa shtetas Shqiptar, me të cilët është takuar por nuk është realizuar largimi i tij për në Angli.

Nga të gjitha veprimet hetimore të kryera për këtë procedim nuk janë gjetur prova dhe fakte që të vërtetojnë lidhjet midis personave të dyshuar si dhe të kenë kryer veprime të cilat mund të realizonin kryerjen e këtyre veprave penale. Personat e dyshuar nuk kanë lidhje me objektin e hetimit, ata nuk kanë qenë në Shqipëri në kohën që kanë filluar hetimet, gjithashtu duhet theksuar se kanë qenë shumë kohë më përpara dhe shumë kohë më pas këtyre hetimeve. Nuk janë gjetur lidhje të këtyre personave për të kryer veprat e tilla penale. Po kështu edhe nga ndjekja e mëtejshme e hetimeve nuk janë konstatuar veprime që të vënë në rrezik jetën e kryetarit të opozitës.

Nga tërësia e të gjitha veprimet hetimore dhe procedurale të kryera në lidhje me procedimin **Nr.147/2017**, nuk është siguruar asnjë e dhënë apo provë për kryerjen e ndonjë vepre penale nga personat e dyshuar.

Për sa më sipër në bazë të nenit 326/1 të Kodit Procedurës Penale,

S u g j e r o j:

Pushimin e Hetimit të **Procedimit Penal Nr. 147, viti 2017**, për veprat penale të “Atentatit”, dhe “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuara nga nenet 219 e 79, të Kodit Penal.

Bashkë me këtë relacion ju dërgojmë 2 (dy) fashikujt e procedimit penal Nr. 147, të vitit 2017 me të gjitha aktet, sipas listës së tyre që përfshihen në fashikull si dhe provat materiale. Fashikulli i parë me gjithsej 352 (treqind e pesëdhjetë e dy flet), fashikulli i dytë gjithsej 138 (njëqind e tridhjetë e dy) flet.

OFICERI I POLICISË GJYQËSORE

Ermal DELIU